



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

PËR

INSPEKTIMIN E VEPRIMTARISË SË

SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE

TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, Nr. 15, datë 28.05.2026)¹

¹ Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për Projekt-Rregulloren e Inspektimit dhe Projekt Rregulloren për Metodologjinë e llogaritjes së Gjohave miratuar për këshillim publik me VKD nr.28 datë 14.11.2025 dhe VKD nr. 4, datë 02.02.2026, janë të publikuar në një dokument më vehte në faqen e internetit të AKEP <https://akep.al/konsultime/konsultime-te-perfunduara/>.

Në mbështetje të nenit 181 e vijues të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe për kundërvajtjet administrative,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

VENDOSI:

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i inspektimit

1. AKEP ushtron veprimtarinë inspektuese me qëllim mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për vlerësimin e përputhshmërisë së saj me përcaktimet e parashikuara me ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (ligj nr.54/2024), aktet e tjera në zbatim të tij, kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhe autorizimet individuale.
2. Qëllimi i rregullores së inspektimit është rregullimi i ushtrimit nga AKEP i veprimtarisë inspektuese sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike të fushës ku ushtrohet veprimtaria, të parashikuara në ligji nr. 54/2024, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të nxjerrë në zbatim të tij.
3. Përcaktimi i parimeve, kriterëve dhe metodologjinë e detajuar që AKEP zbaton për vendosjen dhe llogaritjen e masës së gjobave administrative ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për shkelje të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.
4. Sigurimi që sanksionet administrative të jenë efektive, proporcionale dhe ndëshkuese, në përputhje me standardet e Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike (EECC) dhe ligjit nr. 54/2024.

Neni 2

Parimet e inspektimit

Parimet të cilat udhëheqin ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit nga AKEP janë:

- a) **Pavarësia:** Inspektori apo grupi i inspektimit, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret;
- b) **Proporcionaliteti:** Veprimet e inspektimit kryhen në mënyrë të tillë që ndërhyrja në veprimtarinë e subjektit të inspektimit të jetë vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e

përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit dhe me mjetet më të përshtatshme të arrihet qëllimi i synuar;

- c) **Programimi i inspektimit:** Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësve kryhet sipas një programi me tematika të vlerësuara mbi bazën e analizës së riskut në raport me zbatimin e kushteve të përgjithshme të Autorizimit të Përgjithshëm dhe kushteve specifike sipas autorizimit individual, si dhe nevojën e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, interesit publik dhe në mënyrë veçantë të përdoruesve;
- d) **Informimi i publikut:** AKEP informon sipërmarrësit dhe publikon konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrative të inspektimit në përputhje me përcaktimet ligjore mbi transparencën dhe publikimin e informacionit të parashikuara në ligjin nr. 54/2024 dhe legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.
- e) **Mbrojtja e konfidencialitetit:** Veprimet e inspektimit dhe publikimi i informacionit kryhet në zbatim të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të mbrojtjes së të dhënave që lidhen me sekretin tregtar të sipërmarrësve.
- f) **Parimi i dispozitës më të favorshme:** Inspektori gjatë punës së tij nëse vëren që një sipërmarrës ka zbatuar një ligj i cili është në kundërshtim me një tjetër, atëherë ai është i ligjshëm, si dhe në çdo rast zbaton dispozitën më të favorshme në hierarkinë e ligjeve të barazvlefshëm.

Neni 3

Llojet e inspektimit

1. Inspektimi përfshin çdo formë kontrolli që AKEP kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe autorizimeve individuale nga sipërmarrësi subjekt inspektimi. Inspektimi kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit, si dhe nga zyrat e AKEP për kontrollin e veprimtarisë së monitoruar në distancë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet në fuqi të nxjerra nga AKEP.
2. Inspektimet për nga forma e autorizimit dhe organizimit të tyre ndahen në:
 - a) *Inspektimi i programuar*
 - b) *Inspektimi jashtë programit*

Neni 3/1

Inspektimi i programuar

1. Inspektimi i programuar është inspektimi që kryhet në bazë të programit vjetor të miratuar të inspektimit nga Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP, i cili hartohet në bazë të një matrice për vlerësimin e riskut.
2. Si rregull i përgjithshëm ligjor, çdo sipërmarrës mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit.

Neni 3/2

Inspektimi jashtë programi

1. Përfundimisht, inspektimi mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit me urdhër të posaçëm të Kryetarit të KD-së së AKEP vetëm në rastet kur:
 - a) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik, vendas apo i huaj, ose një organizatë ndërkombëtare, konsiderohet i nevojshëm fillimi i një inspektimi, pas vlerësimit objektiv dhe të argumentuar nga drejtoria përgjegjëse për inspektimin.

- b) ndodhin ngjarje, aksidente apo incidente, që kanë cenuar apo përbëjnë rrezik për të cenuar të drejta dhe interesa të tjera të ligjshme në dëm të konkurrencës efektive, infrastrukturës së rrjeteve apo konsumatorëve;
 - c) në rastet e krizave dhe emergjencës;
 - d) parashikohet nga dispozitat e ligjit nr.54/2024;
2. Një inspektim jashtë programit mund të autorizohet edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga subjekte të tjera, të ndryshme nga ata të parashikuar në gërmën a) të pikës 1 të këtij neni.
3. Inspektim jashtë programit në kushtet e flagrancës, kryhet kur trupa inspektuese konstaton se subjekti po ushtron një veprimtari në shkelje të kërkesave ligjore, e cila duhet dokumentuar me sende ose prova e materiale. Fillimi i inspektimit sipas kësaj pike shoqërohet me nxjerrjen menjëherë të autorizimit nga Kryetari i AKEP.

Neni 4

Organizimi i sistemit të inspektimit në AKEP

1. Sistemi i inspektimit në AKEP përbëhet nga tërësia e strukturave që janë përfshirë dhe kryejnë funksione inspektimi në përbërje të drejtorisë përgjegjëse për inspektimin.
2. Inspektimi kryhet nga inspektorët e emëruar sipas strukturës dhe organikës së AKEP, me grup inspektimi. Pjesë e grupit të inspektimit mund të jenë edhe nëpunës të tjerë të administratës së AKEP, ose ekspertë, në përputhje me fushat përkatëse të objektit, apo çështjes për të cilën kryhet inspektimi.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e strukturës inspektuese të AKEP

1. Roli i drejtorisë përgjegjëse në AKEP për inspektimin është përmirësimi i efektivitetit dhe i përgjegjshmërisë në veprimtarinë e inspektimit nga AKEP në fushën e komunikimeve elektronike. Çdo inspektor i AKEP pajiset me kartën e tij të inspektimit të miratuar sipas (Aneksit X). Karta e inspektimit është pronë e AKEP dhe përbën aktin/dokumentin zyrtar identifikues të inspektorit.
2. Inspektori përgjatë ushtrimit të përgjegjësisë së tij ligjore për inspektimin e subjekteve të parashikuara nga ligji 54/2024, ka të drejtë të:
- a) Hyjë lirisht në mjediset ku sipërmarrësi i komunikimeve elektronike zhvillon veprimtarinë;
 - b) Marrë mostrat e mallrave, materialeve apo produkteve për ekzaminim të mëtejshëm;
 - c) Marrë kopje dhe të sekuestrojë dokumentacionin e veprimtarisë në përputhje me objektin e inspektimit;
 - d) Kërkojë mbështetjen e forcave ligjzbatuese përgjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese.

Neni 6

Të drejtat e subjektit të inspektimit

1. Subjekti i inspektimit, gjatë inspektimit, ka këto të drejta:
- a) Të kërkojë të njihet me urdhrin e inspektimit para fillimit të inspektimit;
 - b) Të kërkojë identifikimin e inspektorëve;
 - c) Të jetë prezent dhe të ndjekë, vetë, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektimit në rastet kur inspektimi kryhet në vendin ku ushtron veprimtarinë;

- d) Të paraqesë mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet, ose materialet përkatëse ku i mbështet ato;
- e) Të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet procesverbali i inspektimit;
- f) Të paraqesë kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret.

Neni 7

Detyrimet e subjektit të inspektimit

1. Subjekti i inspektimit, gjatë inspektimit, ka këto detyrime:
 - a) në rast se nuk ka mundësi të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorët, të caktojë një përfaqësues, si dhe t'i shoqërojë ata në çdo vend/mjedis sipas përcaktimeve në urdhrin e inspektimit;
 - b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit dhe marrjen e provave;
 - c) të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorëve, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si dhe t'u ofrojë atyre qasje në pajisjet dhe/ose infrastrukturën në posedim apo administrim;
 - d) të paraqesë çdo informacion, të dhënë, ose dokument, si dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektorët, duke respektuar edhe afatin kohor të përcaktuar prej tyre;
 - e) të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët.

KAPITULLI II

PROGRAMIMI I VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT

Neni 8

Planifikimi i inspektimit

1. Veprimtaria e inspektimi në AKEP kryhet mbi bazën e programimit si më poshtë:
 - a) **Plani vjetor**, përcakton më në detaje veprimtarinë e inspektimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë. Plani vjetor i inspektimit propozohet nga Drejtoria përgjegjëse për inspektimin dhe hartohet në mbështetje të një matrice risku. Plani vjetor miratohet nga Kryetari i KD-së të AKEP.
 - b) **Plani mujor**, i cili del në zbatim të Planit vjetor, propozohet nga Drejtoria përgjegjëse për inspektimin, dhe miratohet Kryetari i KD-së të AKEP. Plani mujor i inspektimit duhet të mundësojë mbulimin e problematikës së shfaqur në veprimtarinë e sipërmarrësve si dhe tematikës dhe objektivave të planifikuar vjetor.

Neni 9

Planifikimi i inspektimit mbi bazën e riskut

1. Planifikimi i inspektimit përgatitet mbi bazë risku që nënkupton se inspektimi fokusohet në ato subjekte (sipërmarrës) veprimtaria e të cilëve përmban aspekte me mundësi të ushtrimit në mospërputhje të plotë ose në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kuadrin rregullator.

2. Vlerësimi i riskut kryhet gjatë gjithë procesit të inspektimit, veçanërisht në fazat e planifikimit në nivel vjetor, por dhe gjatë procesit të inspektimit. Analiza e riskut, parimisht konsideron faktorët më relevantë me ndikim në treg, si:
 - a) Peshë në treg e subjektit (sipërmarrësit) nga pikëpamja e rrjetit dhe shërbimeve publike që ofron si dhe peshës në treg referuar numrit të përdoruesve;
 - b) Lloji, larmia dhe teknologjia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit për publikun;
 - c) Standardet teknike, infrastruktura dhe cilësia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit;
 - d) Numri i ankesave të pajtimtarëve dhe performanca e sipërmarrësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtimtarët dhe midis sipërmarrësve;
 - e) Performanca e plotësimit të detyrimeve lidhur me sigurinë kombëtare, sigurinë e rrjeteve, mbrojtjen e të dhënave personale, regjistrimin e të dhënave identifikuese të pajtimtarëve, masave për gjendjet e jashtëzakonshme etj;
 - f) Rezultatet historike të inspektimit;
 - g) Indeksi i reagimit dhe plotësimi i rekomandimeve nga sipërmarrësit të rregullimit të shkeljeve të konstatuara dhe vendosura nga inspektorët dhe/ose AKEP, në aktet e inspektimit;
 - h) Performanca e zbatimit të kushteve të veçanta të përcaktuara në aktet e AKEP për përdorimin e burimeve të fundme.
3. Vlerësimi i riskut kryhet duke analizuar në mënyrë të përgjithshëm veprimtarinë e sipërmarrësve të regjistruar në *database-n* e AKEP, referuar faktorëve ndikues të mësipërcituar. Për arsye metodike të vlerësimit, subjektet e inspektimit kategorizohen sipas nivelit të mundshëm të rrezikut të riskut: të lartë, të mesëm dhe të ulët.

KAPITULLI III

RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË AUTORIZIMIT DHE PROCESIT TË INSPEKTIMIT

Neni 10

Formularët e inspektimit

1. Formatet standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit që i bashkëlidhen kësaj rregullore në aneksin 2, janë si më poshtë:
 - a) Urdhër inspektimi;
 - b) Proces-verbal për fillimin e inspektimit;
 - c) Proces-verbal për inspektimin e veprimtarisë së komunikimeve elektronike;
 - d) Proces-verbal për konstatimin e shkeljeve;
 - e) Proces-verbal për ndalimin e funksionimit e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarisë së komunikimeve elektronike;
 - f) Vendim për bllokimin, ndalimin e funksionimit, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarisë së komunikimeve elektronike, pa autorizim nga AKEP;
 - g) Vendimi i inspektimit për masa administrative;
 - h) Karta e inspektorit, e miratuar nga AKEP;
 - i) Vula për bllokimin e pajisjeve transmetuese dhe/ose ndalimin e përdorimit të funksionimit të tyre.

Neni 11

Urdhri i Inspektimit dhe njoftimi i tij te subjekti i inspektimit

1. Inspektimi i një subjekti autorizohet, si rregull, në bazë të programit të inspektimit mujor i cili hartohet dhe miratohet sipas Kapitullit II të kësaj rregulloreje. Përjashtimisht, një inspektim mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit, sipas rasteve të parashikuara në ligjin e veçantë, dhe ligjin për Inspektimin.
2. Rregullisht, me nxjerrjen e urdhrin të inspektimit, subjekti i përcaktuar në inspektim, jo më vonë se 3 (tre) ditë, njoftohet paraprakisht nga kryetari i grupit të inspektimit, nëpërmjet një mesazhi elektronik (email) për inspektimin që do të kryhet duke i dërguar edhe një kopje të skanuar të Urdhrit të Inspektimit. Por, inspektimi pas nxjerrjes së autorizimit mund të kryhet edhe pa e njoftuar paraprakisht subjektin, kjo në varësi të objektit të inspektimit, matricës së riskut dhe rrethanave të faktit. Njoftimi paraprak nuk kryhet kur:
 - a) Ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
 - b) Mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
 - c) Për inspektimin lidhur me verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar;
 - d) Konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkesë ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit;
 - e) Inspektohet për rastin e ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve, që kanë çenuar apo mund të çënojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin.
3. Urdhri i inspektimit shoqërohet me listën e kontrollit që do të ushtrohet nga grupi i inspektimit. Lista e kontrollit i përmbahet objektit të inspektimit dhe konsiston sipas rastit në verifikimin e plotë ose të pjeshëm të:
 - a) Dokumentacionit ligjor të subjektit dhe autorizimet që disponon të lëshuara nga AKEP;
 - b) Dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimeve të pagesave të subjektit për AKEP dhe tarifën e radikomunikacionit;
 - c) Dokumentacionit që vërteton plotësimin e kushteve të përgjithshme sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe kushteve të veçanta sipas autorizimeve individuale për përdorimin e burimeve të fundme dhe akteve të nxjerra nga AKEP;
 - d) Zbatimit të masave dhe kushteve teknike dhe teknologjisë së njoftuar;
 - e) Kapaciteteve për përdorim të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve;
 - f) Disponimit të lejeve dhe akteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të parashikuara si detyrime për t'u zbatuar nga subjekti sipas ligjit nr. 54/2024 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 12

Veprimet e grupit të inspektimit

1. Grupi i inspektimit, në datën e përcaktuar në urdhër, paraqitet në ambientet e subjektit dhe dorëzon urdhrin e inspektimit, listën e kontrollit, si dhe paraqet kartat e inspektorëve të cilët do të kryejnë inspektimin. Pavarësisht nga njoftimi paraprak ose jo i urdhrin të inspektimit, në çdo rast, inspektori përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit dhe për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve dhe në vazhdim metodën e inspektimit e afatet për përfundimin e inspektimit.
2. Subjekti i përcaktuar në autorizimin e inspektimit, me marrjen e njoftimit të inspektimit, është i detyruar ligjërisht dhe merr masat e duhura për ti mundësuar inspektorëve realizimin e inspektimit. Subjekti i inspektimit edhe në rastet e paraqitjes së inspektorëve pa njoftim paraprak, menjëherë pas paraqitjes nga grupi i inspektimit të autorizimit dhe

kartave të inspektorëve, lejon kryerjen e inspektimit duke u angazhuar maksimalisht për të mundësuar kryerjen e veprimeve të inspektimit sipas kërkesave ligjshme të inspektorëve. Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të:

- a) dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar;
 - b) ambjenteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet;
 - c) infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese;
 - d) përgjigjet e pyetjeve të bëra nga inspektorët;
 - e) dhënien e shpjegimeve të nevojshme.
3. Administratori/përfaqësuesi ligjor i subjektit ose personi i autorizuar prej tyre me shkrim sipas statutit të shoqërisë (subjektit të inspektimit), shoqëron inspektorët gjatë kryerjes së veprimeve, si dhe nënshkruan aktet e nxjerra nga inspektori.
 4. Administratori/përfaqësuesi ligjor është përgjegjës për saktësinë e adresës së selisë së subjektit, vendeve dhe ambjenteve të tjera ku ushtron veprimtarinë dhe adresës elektronike të njoftuar në AKEP sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm. Në rast pa saktësie ose njoftimi të rremë të adresës, subjekti penalizohet në përputhje me përcaktimet ligjore.
 5. Mos lejimi i inspektimit dhe krijimi i pengesave të qëllimshme për kryerjen e inspektimit përbëjnë kundërvajtje administrative dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve ligjore.

Neni 13

Kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve

1. Pjesë e procedurës së zbatimit të inspektimit është edhe kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve (sipërmarrësve), i cili kryhet nga inspektorët/ekspertët e AKEP duke e monitoruar atë nga ambjentet ku punojnë ose ku janë vendosur pajisjet monitoruese fikse ose të lëvizshme për monitorimin e përdorimit të frekuencave dhe treguesve të cilësisë së ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve konsiston në:
 - a) Kontrollin e veprimtarisë për të cilën subjektet janë të detyruar të depozitojnë në AKEP dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit;
 - b) Kontrollin e plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm, zbatimin e të cilave është i mundshëm për tu kontrolluar nëpërmjet ekzistencës së tyre publike ose zbatimit të aplikacioneve të ndryshme;
 - c) Kontrollin e përdorimit të spektrit të frekuencave të alokuar sipas autorizimeve individuale të lëshuara nga AKEP sipas ligjit;
 - d) Administrimin e ankesave të paraqitura nga përdoruesit dhe pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
 - e) Administrimin e ankesave ose monitorimeve të kryera nga institucione të tjera shtetërore ose publike për fusha të caktuara dhe që kanë lidhje me zbatimin e ligjit nr. 54/2024 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Rezultatet e kontrollit në distancë iu vihen në dispozicion subjekteve nga AKEP të shoqëruar me provat e administruara, rekomandimet përkatëse me afate të përcaktuara, për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, si dhe me aktet administrative të aplikimit të masave administrative të mundshme të parashikuara në ligj për kundërvajtjet administrative duke zbatuar për këtë një procedurë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 14

Procesi i gjetjeve të inspektimit

1. Inspektorët gjatë inspektimit kontrollojnë veprimtarinë subjektit vetëm për sa është përcaktuar në objektin e Urdhrit të inspektimit dhe listës së kontrollit. Nëse gjatë inspektimit konstatohen shkelje ose parregullsi të cilat nuk janë parashikuar në objektin e Urdhrit të inspektimit, inspektorët njoftojnë Kryetarin e KD-së të AKEP dhe kërkojnë zgjerim të objektit të inspektimit. Kryetari i KD-së të AKEP, në varësi të riskut dhe rrethanave faktike vendos për zgjerimin e objektit të urdhrin ose nxjerr një urdhër të ri duke caktuar një grup tjetër inspektimi.

Neni 15

Procesverbali i inspektimit

1. Procesverbali i inspektimit si rregull plotësohet gjatë punës në terren nga përgjegjësi i grupit të inspektimit në bashkëpunim me inspektorët/ekspertët të cilët kryejnë inspektimin e subjektit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Inspektorët/ekspertët në përbërje të grupit të punës duhet të bien dakort për saktësinë e gjetjeve faktike të tyre, nga puna në terren.
2. Nëse përfundimi i procesverbalit në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e AKEP dhe njoftohet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të inspektimit në subjekt. Me përfundimin e këtij afati, brenda 30 ditëve, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit. Procesverbali mbahet në 3 (tre) kopje dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Në rast mosdakortësie, inspektori/eksperti që ka qëndrim të ndryshëm nga pjesa tjetër e grupit, bën me shkrim observacionin e tij duke arsyetuar dhe mbështetur gjetjen e tij në bazë ligjore dhe prova.
3. Procesverbali fillon me evidentimin e të dhënave të përgjithshme:
 - a) Të dhënat mbi subjektin;
 - b) Saktësia e adresës së njoftuar;
 - c) Njoftimi i inspektimit ose jo;
 - d) Autorizimi i inspektimit së bashku me objektin e inspektimit dhe listën e kontrollit;
 - e) Lejimi ose pengimi i inspektimit;
 - f) Pjesmarja apo përjashtimi i përfaqësuesit të autorizuar të subjektit duke regjistruar dhe arsyen e përjashtimit.
4. Në procesverbal grupi i inspektimit, në mënyrë kronologjike regjistron të gjithë punën që ka bërë, ku shënon të gjitha gjetjet në subjekt si dhe bën evidentimin e tërë dokumentacionit të verifikuar. Në procesverbal evidentohen shkeljet e konstatuara, provat që vërtetojnë shkeljen, dokumentet e sekuestruara dhe pajisjet e bllokuara (nëse ka të tilla) etj, masat administrative të propozuara ose vendosura, komunikimi i të drejtave që disponon subjekti ligjorisht për ankim, si dhe detyrat dhe rekomandimet e lëna. Pjesë e pandarë e procesverbalit është edhe “Lista e kontrollit”.
5. Në mbyllje bëhet formalizimi i procedurës duke nënshkruar inspektorët dhe subjekti. Subjekti është i detyruar të nënshkruajë në çdo rast procesverbalin. Nëse subjekti nuk bie dakort me procesverbalin e nënshkruan atë “*me rezervë*” dhe depoziton kundërshtimet e tij në AKEP, brenda 8 (tetë) ditëve nga marrja dijeni e procesverbalit. Procesverbali i pa nënshkruar nga subjekti i inspektimit, i pa shoqëruar me shënimin “*nënshkrim me rezervë*” dhe aktin e parashtrimit të kundërshtimeve, konsiderohet i vlefshëm dhe ka të njejtën fuqi juridike si të jetë i nënshkruar rregullisht nga subjekti.

Neni 16

Masat urgjente

1. Inspektori gjatë inspektimit, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur për shkak të shkeljes së konstatuar ose kur ka një dyshim të arsyeshëm që për shkelje të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i

interesit publik, është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo testeve.

2. Nëse është e mundur, qëllimi për të marrë një masë urgjente i njoftohet, paraprakisht, në mënyrë verbale, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, duke i dhënë mundësinë për të paraqitur pa vonesë komentet dhe shpjegimet përkatëse.
3. Inspektori evidenton në procesverbalin e inspektimit edhe masat urgjente të marra për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore dhe të efektit të dëmshëm të menjëhershëm që mund t'i vijë sigurisë publike. Në rast të marrjes së masave urgjente plotësohet "Procesverbal" (aty për aty) dhe Vendimi i ndërmjetëm të cilët kanë hapësirë për ngarkim dokumenti në procesverbalin e inspektimit.
4. Masat urgjente janë:
 - a) Ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;
 - b) Ndalimi i funksionimit të një instalimi rrjeti apo pajisje;
 - c) Bllokimi i pajisjeve të paautorizuara;
 - d) Urdhëri i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme;
 - e) Çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

Neni 17

Vendimi i ndërmjetëm

1. Vendimi i ndërmjetëm është me ekzekutim të menjëhershëm. Nëse nuk ekzekutohet vullnetarisht, pa vonesë nga subjekti i inspektimit apo nëse ai bën të ditur ose nga rrethanat rezulton se nuk do ta ekzekutojë vendimin, vendimi ekzekutohet menjëherë nga inspektori përkatës në përbërje të grupit të inspektimit, me shpenzimet e subjektit të inspektimit, të cilat pasqyrohen në vendimin përfundimtar apo në një akt të veçantë.
2. Kundër vendimit të masës urgjente me përjashtim të gërmasë "c" të pikës 4 të nenit 16, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditësh, tek Këshilli Drejtues i AKEP. Trajtimi i ankesës dhe hartimi i akteve për shqyrtim dhe miratim në KD bëhet nga drejtoria që mbulon çështjet ligjore dhe drejtoria që mbulon inspektimin.
3. Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe nëse nuk është parashikuar një afat i tillë, me:
 - a) Njoftimin e revokimit të tij;
 - b) Njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
 - c) Skadimi i afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
 - d) Njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;
 - e) Skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrative ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
 - f) Urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.
4. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale. Një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje njoftohet brenda 24 orëve. Masat urgjente mund të merren deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 18

Vendimi përfundimtar

1. Vendimi përfundimtar i inspektimit është akti që mbyll një procedurë inspektimi dhe nxirret nga grupi i inspektimit pas nënshkrimit të procesverbalit. Në rastet kur janë konstatuar shkelje, grupi i inspektimit bazuar në procesverbalin e inspektimit dhe administrimin e

shpjegimeve, provave dhe kundërshtimeve të dhëna nga subjekti i inspektimit, përpilon vendimin përfundimtar të inspektimit dhe brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit, dhe ia dërgon atë subjektit të inspektimit duke përcaktuar edhe masat administrative. Në rastet kur nuk janë konstatuar shkelje vendimi përfundimtar i inspektimit bashkëlidhet procesverbalit dhe i dorëzohet subjektit në vend dhe njëkohësisht.

Neni 19

Kriteret për vendosjen e masave administrative

1. Kur nga procedura e inspektimit konstatohet se një sipërmarrës ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 54/2024, inspektorët e AKEP marrin masë administrative sipas këtij ligji. Inspektorët për vendosjen e gjobës ose masës administrative, mbajnë parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
 - b) rrethanat në të cilat është kryer shkelja;
 - c) nëse sipërmarrësi ka një histori të shkeljeve të detyrimeve;
 - d) pasojat që kanë ardhur nga shkelja e konstatuar.
2. Masa e gjobës përllogaritet sipas Aneksit 1, “Metodologji për përllogaritjen e masës administrative me gjobë” të kësaj rregulloreje.
3. Në rastet kur inspektorët propozojnë tek Këshilli Drejtues i AKEP, marrjen e masave administrative të parashikuara në pikën 5 të nenit 183 të ligjit 54/2024, subjekti ruan të drejtën e dëgjësës në seancë dëgjimore, me qëllim krijimin e mundësisë për të dhënë shpjegime.
4. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi shqyrton propozimin e inspektorëve në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 183 të ligjit nr. 54/2024, si dhe pas kryerjes së seancës dëgjimore me subjektin, vendos:
 - a) Të paralajmërojë sipërmarrësin me shkrim, duke përcaktuar shkeljen e bërë, si dhe duke i lënë një afat të arsyeshëm për ndreqjen e shkeljes;
 - b) Në rast se sipërmarrësi nuk plotëson detyrimet brenda afatit të lënë nga Këshilli Drejtues i AKEP-it, Këshilli Drejtues vendos për revokimin e:
 - i. së drejtës së përdorimit të një ose më shumë frekuencave ose numeracioni; ose
 - ii. së drejtës së ofrimit të shërbimeve ose të rrjeteve të komunikimeve elektronike.
5. Kundër vendimit të KD-së të AKEP, mund të paraqitet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 20

Bllokimi i pasijeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre

1. Bllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre, si dhe inventarizimi dhe sekuestrimi i tyre bëhet në përputhje me nenin 182 të ligjit nr. 54/2024.
2. Në rast se inspektorët, gjatë inspektimit, zbulojnë se pajisjet radio të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë licenca/autorizimi përkatës, marrin vendimin për ndalimin e funksionimit të tyre, i cili i njoftohet përfaqësuesit të subjektit menjëherë.
3. Ndalimi i funksionimit të pajisjeve bëhet përmes procesverbalit përkatës të ndalimit të funksionimit të tyre, i cili nënshkruhet nga inspektorët, si dhe një përfaqësues i subjektit. Në rast se përfaqësuesi i subjektit refuzon nënshkrimin, ky fakt shënohet në procesverbal dhe procesverbali afishohet në vendin e inspektimit.
4. Përkundrejt kërkesës me shkrim të subjektit që ka shkaktuar interferencën, inspektorët bëjnë verifikimin e nevojshëm dhe, nëse vërejnë se interferencat e dëmshme janë shmangur, vendosin për lejimin e funksionimit të mëtejshëm të pajisjes së ndaluar.

5. Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike pa autorizim/licencë nga AKEP, inspektorët marrin vendimin për bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e saj, i cili i njoftohet përfaqësuesit të subjektit menjëherë.
6. Inventarizimi dhe sekuestrimi i pajisjeve bëhet përmes procesverbalit përkatës të bllokimit, inventarizimit dhe sekuestrimit të pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarisë së komunikimeve elektronike pa autorizim nga AKEP, i cili nënshkruhet nga inspektorët, si dhe një përfaqësues i subjektit. Në rast se përfaqësuesi i subjektit refuzon nënshkrimin, ky fakt shënohet në procesverbal dhe procesverbali afishohet në vendin e inspektimit.
7. Pajisjet e bllokuara, inventarizohen dhe sekuestrohen. Me kalimin e afatit 30-ditor nga data e bllokimit, nëse nuk është bërë ankimi nga sipërmarrësi, Kryetari i AKEP urdhëron kalimin e pajisjeve për shitje organit kompetent të ngarkuar me ligj, sipas parashikimeve të ligjit për kundravajtjet administrative nr.10279/2010.
8. Për zbatimin e detyrave për bllokimin e pajisjeve, AKEP-i bashkëpunon me autoritetet publike lokale, me Policinë e Shtetit dhe me shërbimin përmbartimor.
9. Bllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre tregohet më vullë, përmbajtja e të cilës është sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregullore.

Neni 21

Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit

1. Pas dhënies së vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtën e ankimit administrativ kundër gjombës së vendosur. Ankimi administrativ i drejtohet Këshillit Drejtues të AKEP, brenda 30 ditëve nga dita kur subjekti i inspektimit ka marrë njoftim për Vendimin përfundimtar, ku përcaktohet edhe e drejta për të paraqitur ankimin pranë Këshillit Drejtues të AKEP për gjombën e vënë.
2. Paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimit, por paraqitja e ankimit administrativ nuk çënon ekzekutimin e masave urgjente të marra nga grupi i inspektimit gjatë procesit të inspektimit.

Neni 22

Vendimmarrja e Këshillit Drejtues

1. Me marrjen e ankimit, Kabineti i Kryetarit të KD vë në dijeni Këshillin Drejtues dhe përcjell ankimin sëbashku me praktikën dokumentare shoqëruese, drejtorisë që mbulon çështjet ligjore dhe drejtorisë që mbulon inspektimin.
2. Drejtoritë sipas pikës 1 të këtij neni, trajtojnë ankimin duke përpiluar opinionin dhe aktet për shqyrtim në mbledhjen e KD. Afati i shqyrtimit të ankimit është 30 ditë nga data e depozitimit të ankimit dhe procedura zbatohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit Këshilli Drejtues nxjerr një vendim përfundimtar i cili i dërgohet subjektit dhe strukturave inspektuese të AKEP për ekzekutimin e tij.
3. Kundër vendimit të Këshillit Drejtues subjekti i inspektuar ka të drejtë të paraqesë ankim në Gjykatë në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit përfundimtar

1. Me përfundimin e procedurës së ankimit dhe nxjerrjen e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP, struktura përgjegjëse inspektuese i përcjell drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin financiar, praktikën dokumentare sipas dosjes së hapur nga grupi i inspektimit, me qëllim

vjeljen e gjobës nëpërmjet ekzekutimit vullnetar të detyrimit brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes njoftim nga subjekti i inspektimit ose publikimit të kërkesës së ekzekutimit vullnetar.

2. Sipas parashikimit të dhënë në nenin 184 të ligjit nr.54/2024, në rast se gjoba e vendosur paguhet nga subjekti përgjegjës brenda 30 ditëve (*ekzekutim vullnetar*) nga njoftimi i vendimit përkatës të AKEP-it, masa e gjobës ulet automatikisht me 15% të shumës së vendosur.
3. Pas periudhës së ekzekutimit vullnetar, nëse subjekti nuk e zbaton ekzekutimin e vendimit, për ekzekutimin e vendimit përfundimtar strukturat përgjegjëse në AKEP nisin procedurat e ekzekutimit nëpërmjet shërbimeve përmbartimore.

Neni 24

Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi

1. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohen në një fletë shoqëruese.
2. Struktura përgjegjëse e inspektimit harton procesin e ndjekjes së korrigjimeve të shkeljeve të konstatuara për të monitoruar dhe për të siguruar që detyrat e lëna janë zbatuar me efektivitet, për këtë planifikohen edhe inspektime për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna nga inspektimi mëparshëm. Afatet e kësaj forme inspektimi nuk përfshihen në afatet e përgjithshme të vendosura për kohën maksimale të qëndrimit në një subjekt inspektimi për periudhën ushtrimore.
3. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar nga inspektorët në fletë porosinë e lënë së bashku me vendimin përfundimtar të inspektimit të mëparshëm dhe, nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
4. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri. Inspektimi i ndjekjes së korrigjimit të shkeljeve të lëna nga inspektimi siguron se subjekti i inspektimit ka përfunduar punën për të cilën kanë qenë informuar nga vendimi përfundimtar dhe fletë porosia e inspektimit.
5. Megjithatë të gjitha detyrat e lëna nga grupi i inspektimit janë të rëndësishme, disa mund të jenë më të rëndësishme se të tjerat. Si rrjedhojë inspektorët duhet të përcaktojnë një nivel rëndësie për secilën detyrë dhe tre kriteret që duhet të përdoren për vlerësimin e tyre janë si më poshtë:
 - a) **I lartë** – Kjo vlen për parregullsi të rëndësishme të konstatuara gjatë inspektimit dhe është një problem që duhet të adresohet menjëherë nga subjekti i inspektimit nga rrezikshmëri e lartë.
 - b) **I mesëm** – Kjo vlen për një parregullsi të rëndësishme të konstatuar gjatë inspektimit. Një gjë e tillë duhet të adresohet menjëherë nga subjekti i inspektimit por jo nga rrezikshmëri e lartë.
 - c) **I ulët** – kjo vlen kur janë identifikuar parregullsi të vogla (jo të rëndësishme) gjatë inspektimit. Ndryshimet duhet të zbatohen me kalimin e kohës, por nuk janë primare që subjekti t'i adresojë ato menjëherë.

Neni 25

Raportimi i ndjekjes së detyrave të lëna

1. Disa subjekte, apo fusha inspektimi mund të jenë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së inspektimit të AKEP dhe si rrjedhojë mund të kontrollohen çdo vit. Në këto raste, inspektorët duhet të përfshijnë progresin në zbatimin e detyrave të lëna në inspektimin e

mëparshëm për atë subjekt apo fushë inspektimi. Inspektorët në vitin në vazhdim, duhet ti kërkojnë subjektit të inspektimit raportime periodike, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë përsa i përket zbatimit të detyrave për korrigjimin e shkeljeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

2. Inspektorët përmbledhin gjetjet qartë/saktë dhe i evidentojnë ato pjesë të caktuara të procesverbalit të inspektimit dhe duhet të tregohen të vëmendshëm si ndaj reagimeve të subjektit, ashtu dhe ndaj afatit për zbatimin e detyrave të lëna.
3. Të gjitha detyrat e lëna nga inspektorët në përfundim të procedurës së inspektimit duhet të jenë:
 - a) Specifike për veprimet që duhet të ndërmerret subjekti i inspektimit;
 - b) Të dobishme, praktike dhe të bazuar në vlerësimin e mundësisë së subjektit të inspektimit për ti zbatuar ato;
 - c) Të marrin në konsideratë edhe koston e zbatimit dhe nëse kostoja e zbatimit është e konsiderueshme, atëherë kjo duhet të raportohet.

KAPITULLI IV

RAPORTIMI DHE KOMUNIKIMI I INSPEKTIMIT

Neni 26

Struktura e raporteve të inspektimit

Struktura e raporteve të inspektimit në AKEP përmban titujt kryesorë:

- a) Përmbledhjen ekzekutive;
- b) Hyrjen;
- c) Metodën e inspektimit;
- d) Gjetjet dhe konkluzionet;
- e) Rekomandimet.

Neni 27

Raportet periodike dhe raporti vjetor i inspektimit

1. Raportet e inspektimit përgatiten nga sektori i inspektimit dhe pasi konfirmohen nga drejtori i strukturës përgjegjëse për inspektimin përcillen në Kabinet për procedurë. Kabineti pasi merr miratimin e Kryetarit e përcjell raportin vjetor në Këshillin Drejtues të AKEP. Raportet janë mujore dhe vjetore.
2. Raportet mujore shërbejnë për të pasqyruar punën e bërë dhe pritshmëritë, ndërsa raporti vjetor pasqyron në mënyrë analitike edhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve.
3. Raporti vjetor duhet të jetë objektiv, i drejtë dhe të përfshijë të gjithë fushat e inspektimit në juridiksionin e AKEP. Format i tij duhet të përmbajë kryesisht:
 - a) Titujt kryesorë dhe nëntitujt e duhur;
 - b) Komentet për dokumentet e punës, si dhe raportet periodike;
 - c) Shembujt për të mbështetur komentet e dhëna;
 - d) Përmbledhjen, ku të jepet një përshkrim i shkurtër i aktivitetit inspektues të kryer;
 - e) Rekomandime konstruktive dhe përmirësime të sugjeruara;
 - f) Objektivat për vitin pasardhës.

KAPITULLI V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 28
Dispozitë kalimtare

Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, zbatohen dispozitat e rregullores “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr.46, datë 27.10.2016 të AKEP.

Neni 29
Shfuqizime

Rregullorja nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, shfuqizohet.

Neni 30
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore, Aneksi 1 dhe Formularët që i bashkëlidhen hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP.

ANEKSI 1: METODOLOGJIA PËR PËRLLOGARITJEN E MASËS ADMINISTRATIVE ME GJOBË

HYRJE

Metodologjia e përllogaritjes së masës së gjobave është dokumenti që kërkohet të miratohet me autorizim ligjor nga ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të procedurave të inspektimit nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Neni 184 i ligjit nr. 54/2024 (Gjobat), nuk parashikon masa fikse të sanksioneve me gjobë, por përcakton sanksione me bazë qarkullimin vjetor bruto, sipas modeleve moderne të përdorura në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, vendosja arbitrare e masës së gjobave apo pa arsyetim ligjor shterues vlerësohet të jetë jashtëzakonisht vulnerabël ndaj shqyrtimit gjyqësor të tyre, duke minuar seriozisht punën inspektuese të AKEP në sektorin e komunikimeve elektronike.

Kuadri ligjor evropian kërkon një qasje rigoroze, dhe strukturore që të sintetizojë brenda një metodologjie për përllogaritjen e sanksioneve me gjobë, dy element të rëndësishëm të procesit të vendimmarrjes së autoritetit, kur jep një masë administrative sanksionuese, atë ekonomik dhe të mbrojtjes së të drejtave themelore.

Sa më sipër, AKEP, ka hartuar dhe miratuar këtë metodologji për përllogaritjen e masës së gjobave në përputhje të plotë me ligjin nr. 54/2024, duke e bërë pjesë të Rregullores së Inspektimit, si një instrument apo dokument rregullator detyrues për strukturat inspektuese të AKEP me qëllim vlerësimin sa më proporcional, transparent dhe efektiv të sanksioneve me gjobë ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike që kryejnë apo ushtrojnë aktivitet në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 54/2024.

Metodologjia, është hartuar mbi bazën e 3 (tre) parimeve kryesore mbi të cilat duhet të ndiqet i gjithë procesi i inspektimit, në çdo fazë të tij. Konkretisht, metodologjia e hartuar nga AKEP merr në konsideratë parimin e “*proporcionalitetit*”, “*efektivitetit*” dhe parimit për të krijuar efekt “*parandalues*”. Të 3 parimet e përmendura janë ç’ka dhe Kodi Evropian i komunikimeve elektronike parashikon për procesin apo procedurën e vendosjes së masës së dënimit me gjobë.

Parashikimi konkret sa i përket metodologjisë së përllogaritjes së masës së gjobës, i dhënë në seksionin III të këtij Aneksi të Rregullores, përcakton ndarjen e procesit/procedurës në 4 faza apo hapa, duke marrë për bazë modelin e dhënë në Rregulloren e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR).

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

- 1.1. Kjo metodologji përcakton parimet, kriteret dhe metodologjinë e detajuar që AKEP zbaton për vendosjen dhe llogaritjen e masës së gjobave administrative ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (në vijim “Sipërmarrësi”) për shkelje të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.
- 1.2. Qëllimi është sigurimi që sanksionet/masat administrative me gjobë të jenë efektive, proporcionale dhe ndëshkuese, në përputhje me standardet e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC) dhe ligjin nr. 54/2024.

2. Baza ligjore

Kjo metodologji hartohet në zbatim të pikës 3 të nenit 183 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

3. Fusha e zbatimit

- 3.1. Kjo metodologji është e zbatueshme nga strukturat inspektuese dhe strukturat drejtuese të AKEP-it, sipas dispozitave të ligjit nr.54/2024.
- 3.2. Rregullat e parashikuara në këtë metodologji aplikohen kur masat administrative me gjobë janë të përcaktuara në kufij maksimalë.

II. RREGULLA PËR VENDOSJEN E DËNIMIT ADMINISTRATIV

4. Vendosja e dënimit administrativ

- 4.1. Kjo metodologji përcakton dhe siguron që vendimet më dënim administrativ me gjobë të jenë proporcionale, efektive dhe me efekt parandalues.
- 4.2. Në veçanti, niveli i dënimit duhet të jetë proporcional për të pasur ndikimin e duhur tek subjektet e inspektuara me qëllim ndërgjegjësimin proaktiv të tyre për zbatimin korrekt të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e komunikimeve elektronike.

5. Nivelet maksimale të masës së gjobave

- 5.1. Nivelet maksimale të gjobave janë përcaktuar në nenin 184 të ligjit nr. 54/2024, të ndarë sipas kategorive të shkeljeve, duke u bazuar në të ardhurat vjetore nga komunikimet elektronike të subjektit për vitin kalendarik të mëparshëm.
- 5.2. Nivelet e parashikuara të sanksioneve me gjobë janë si më poshtë:
 - a) Deri në 3% të të ardhurave vjetore të realizuara në vitin e fundit financiar të mbyllur, por jo më shumë se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, për shkeljet e përcaktuara në shkronjën a), të pikës 1 të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024;
 - b) Deri në 2% për qind të të ardhurave vjetore të realizuara në vitin e fundit financiar të mbyllur, por jo më shumë se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, për shkeljet e përcaktuara në shkronjën b), të pikës 1 të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024;
 - c) Deri në masën 1 000 000 (një milionë) lekë, për shkeljet e përcaktuara në shkronjën c), të pikës 1 të nenit 184 të ligjit 54/2024;
 - d) Në rast se shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024, kryhen nga një subjekt, i cili është në vitin e parë të aktivitetit dhe nuk mund të ketë të dhëna për të ardhurat vjetore të realizuara në vitin e fundit financiar të mbyllur, dënohet me gjobë në masën nga 1 000 000 (një milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.
- 5.3. Asnjë masë administrative gjobë nuk mund të jetë nën kufirin minimal të gjobës së përcaktuar në shkronjën “ç”, pika 1 të nenit 184 të ligjit nr. 54/2024, pavarësisht të ardhurave vjetore të realizuara nga sipërmarrësi.

6. Kriteret përcaktuese të masës së gjobës

- 6.1. Për të siguruar proporcionalitetin në vendosjen e masës së gjobave, strukturat përgjegjëse të inspektimit duhet të mbajnë në konsideratë kriteret përcaktuese të masës së gjobës të renditura si më poshtë:

- a) Rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes ligjore;
- b) Shkalla e dëmit të ardhur si pasojë e kryerjes së shkeljes;
- c) Pësia e fajsisë së subjektit në kryerjen e shkeljes;
- d) Historia e shkeljeve të detyrimeve.

7. Rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes

7.1. Ky kriter fokusohet mbi natyrën objektive, qëllimit, dhe vazhdimësisë në kohë të shkeljes.

7.2. Për identifikimin e natyrës së shkeljes, struktura inspektuese vlerëson:

- a) rëndësinë e parashikimit ligjor të shkelur, e konkretisht për dispozitat mbi sigurinë dhe integritetin e rrjeteve, atyre që rregullojnë sjelljen konkurruese në treg, dispozitave për mbrojtjen e konsumatorit rëndësia është më e lartë.
- b) përcakton nëse shkelja prek apo lidhet me një aktivitet apo shërbim thelbësor apo dytësor.

7.3. Për përcaktimin e kriterit të kohëzgjatjes së shkeljes, struktura inspektuese, vlerëson:

- a) hapësirën kohore nga fillimi i shkeljes deri në ndalimin e tij ose deri në momentin e konstatimit të shkeljes nga inspektori i AKEP. Kohëzgjatje më e madhe përbën faktor rëndësues.
- b) mosveprimin në kohë për të ndrequr shkeljen dhe pas tërheqes së vëmëndjes nga AKEP.

8. Dëmi i ardhur si pasojë e kryerjes së shkeljes

8.1. Ky kriter shërben për të përcaktuar efektin apo pasojën që ka krijuar shkelja ligjore e subjektit.

8.2. Kriteri kategorizohet si vijon sipas llojit të dëmit:

- a) *Dëm financiar*: vlerësohet dëmi financiar i shkaktuar ndaj konsumatorit, subjekteve konkurruese apo palëve të treta.
- b) *Dëm jofinanciar*: inspektori vlerëson nëse nga shkelja ka ardhur pasojë jo financiare si: mos ruajtja e detyrimit të konfidencialitetit, rënia e cilësisë së shërbimit etj.
- c) *Dëm ndaj konkurrencës në treg*: shkeljet me efekte në dëm të konkurrencës si pengimi i tregut apo çmime të padrejta, do të rezultojnë me sanksione më të rënda.

III. PËRLLOGARITJA E MASËS SË GJOBËS

9. Fazat për përllogaritjen e masës së gjobës

Procesi i llogaritjes së masës së gjobës ndjek katër faza/hapa, si vijon:

9.1. Hapi i parë: Përcaktimi i nivelit maksimal referencial të gjobës:

- a) Përcaktohet konkretisht neni, apo paragrafi i ligjit nr. 54/2024 që është shkelur;
- b) Përcaktohet niveli maksimal i gjobës, sipas pikës 5.2 të këtij Aneksi të Rregullores;
- c) Identifikohet vlera e të ardhurave vjetore të realizuar gjatë vitit kalendarik të mëparshëm të subjektit. Nëse vlera e gjobës e llogaritur në përqindje ndaj të ardhurave vjetore të subjektit tejkalon nivelin maksimal fiks të gjobës (tavani i gjobës i shprehur në Lekë), i përcaktuar nga neni 184, të ligjit nr. 54/2024, aplikohet gjithmonë ky i fundit.

- d) Në rast se evidentohen shkelje të lidhura teknikisht, masa e gjobës nuk duhet të tejkalojë tavanin e e shkeljes më të rëndë.

9.2. Hapi i dytë: Vlerësimi i masës së gjobës sipas kriterëve të dhëna në pikën 6 të Aneksit 1 të kësaj Rregulloreje.

- a) Niveli fillestar i gjobës, llogaritet duke marrë në analizë kriteret e përcaktuara në pikën 6 të Aneksit 1 të kësaj Rregulloreje, kriteret që burojnë nga neni 183 (2) i ligjit nr. 54/2024, e kategorizuar me përqindje si vijon:

Kategoria	Kriteret përcaktuese të masës së gjobës	Vlera e gjobës
I ulët	Pasoja të lehta të ardhura nga shkelja, të kryera në periudha të shkurtra.	Deri në 10% të nivelit maksimal të gjobës
I mesëm	Pasoja jo shumë të rënda të ardhura nga shkelja e kryer, në kohëzgjatje relativisht jo të gjatë.	10% - 30% të nivelit maksimal të gjobës
I lartë	Pasoja shumë të rënda dhe të shtrira në disa nivele të ardhura nga shkelja e kryer, e përsëritur në kohë të gjatë.	30% - 100% të nivelit maksimal të gjobës.

- b) Pas identifikimit të përqindjes sipas shkronjës “a” të kësaj pike (9.2/a), për llogaritjen e gjobës, do të aplikohet shumëzimi i përqindjes me nivelin maksimal të gjobës.

$$\text{Masa e Gjobës} = \text{Niveli i Përqindjes} \times \text{Niveli maksimal i gjobës}$$

9.3. Hapi i tretë: Aplikimi i faktorëve rëndues e lehtësues mbi masën e gjobës

Ndaj masës së gjobës së nxjerrë/llogaritur sipas hapave të mësipërm (pikat 9.1 dhe 9.2) aplikohen faktorë të tjerë rëndues apo lehtësues, (duke shtuar apo hequr me nivel përqindje) bazuar në sjelljen dhe aktivitetin e subjektit:

a) Faktorë rëndues:

- Subjekti është përsëritës (+ 10%).
- Tentativë për të manipuluar provat apo penguar aktivitetin inspektues (+10%).

b) Faktorë lehtësues:

- Vullnet i shprehur dhe faktuar për ndreqjen e menjëhershme të shkeljes (-10%).
- Bashkëpunim i plotë me strukturën inspektuese (-10%).
- Raportimi vullnetar i shkeljes së ligjit (-10%)

9.4. Hapi i katërt: Ekzekutimi vullnetar i gjobës

- Verifikimi i respektimit të nivelit maksimal fiks të parashikuar nga neni 184 i ligjit.
- Ekzekutimi vullnetar i masës së gjobës. Në këtë rast do të aplikohet parashikimi i pikës 3 të nenit 184, të ligjit nr. 54/2024, për reduktimin në masën 15% të masës së gjobës në rast të shlyerjes së saj brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.

ANEKSI 2: FORMATE STANDARD PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. ____ prot.,

Tiranë më ____.

URDHËR INSPEKTIMI

Nr. ____, Datë ____.

Bazuar në nenin 181 e në vijim të ligjit nr.54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, urdhëroj inspektimin e subjektit/eve, si më poshtë:

Të dhëna mbi subjektin/et e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit:

Inspektorët e autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

3. _____ ID: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i urdhrit të inspektimit subjektit/eve të inspektimit: Po ☐ Jo ☐

Njoftimi paraprak i urdhrit të inspektimit, nuk njoftohet për arsye: _____

K R Y E T A R I

Nënshkrimi, vula e instituconit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. ____ prot.,

Tiranë më _____._____._____

PROCESVERBAL PËR FILLIMIN E INSPEKTIMIT

I mbajtur sot, më datë _____._____._____, në ambientet e sipërmarrësit/subjektit,
_____, me adresë në _____, nga

Inspektorët e AKEP:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të AKEP, me Nr. _____, datë _____._____._____, “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve/subjekteve të komunikimeve elektronike”, Grupi i Inspektimit, njofton subjektin _____, përfaqësuar nga _____ në pozicionin e _____ të këtij subjekti, mbi objektin e Urdhrit Nr. _____, datë _____ të Kryetarit të AKEP.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin _____, të rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. _____, datë _____._____._____, të Këshillit Drejtues të AKEP, u mbajt ky procesverbal prezence, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së inspektimit.

GRUPI I INSPEKTIMIT

PËR SUBJEKTIN E INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. ____ prot.,

Tiranë më ____.

PROCES VERBAL Nr. ____

PËR INSPEKTIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

I mbajtur sot, më datë ____, nga Grupi i Inspektimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) bazuar në Urdhrin Nr. ____ datë ____, të Kryetarit të AKEP, në subjektin _____, me adresë _____, në prezencë të përfaqësuesit të subjektit të inspektimit _____, gjatë ushtrimit të inspektimit të veprimtarisë së komunikimeve elektronike.

Njoftim paraprak lënë subjektit:

Po ☐

Jo ☐

Inspektim me urdhër:

Po ☐

Jo ☐

Inspektim në vend

Po ☐

Jo ☐ (Distancë)

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐

Jo ☐

Masa urgjente:

Po ☐

Jo ☐

U KONSTATUA:

1. Prova (mostra) të marra:

Po ☐

Jo ☐

2. Dokumente të marra:

Nr. dokumenti i marrë dhe përshkrimi i nr. të fletëve:

1. _____

2. _____

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni:

Nr. dokumenti i sekuestruar dhe përshkrimi i nr. fletëve

1. _____
2. _____

4. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektorit

Po ☐

Jo ☐

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, më datë __.__.____, ora __:__, të paraqitet në adresën: _____, për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesin:

1. _____
2. _____
3. _____

Dokumente të paraqitura:

Nr. dokumenti dhe përshkrimi i nr. i fletëve

1. _____
2. _____

Sende të paraqitura:

Nr. sendi dhe përshkrimi _____ copë

1. _____
2. _____

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Grupit të Inspektimit referuar pikës 3, të nenit 181 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në ligjin nr. 54, datë 30.05.2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. ____ datë _____._____._____, të Këshillit Drejtues të AKEP, u mbajt ky procesverbal inspektimi, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

GRUPI I INSPEKTIMIT

PËR SUBJEKTIN E INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. _____ prot.,

Tiranë më ____ . ____ . ____

**PROCESVERBAL NR. ____
PËR KONSTATIMIN E SHKELJEVE**

Bazuar në Urdhrin nr. _____, datë ____ . ____ . _____, të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe në vijim të procesverbalit nr. _____, datë ____ . ____ . _____, Grupi i Inspektimit, gjatë ushtrimit të kontrollit të ushtruar [në distancë/ në vend] të subjektit të inspektimit _____, dhe në prezencë/jo në prezencë të përfaqësuesit të subjektit _____, konstatoi shkeljet si më si më poshtë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

GRUPI I INSPEKTIMIT

PËR SUBJEKTIN E INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. _____ prot.,

Tiranë më ____ . ____ . ____

PROCESVERBAL NR. _____
PËR NDALIMIN E FUNKSIONIMIT TË PAJISJEVE TË PËRDORURA NGA
SUBJEKTI _____ GJATË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

I mbajtur sot, në datë _____, në ambientet e subjektit _____, me adresë në _____, në prezencë të përfaqësuesit të subjektit _____, Grupi i Inspektimit, bazuar në nenin 182 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. _____, datë ____ . ____ . ____ të Këshillit Drejtues të AKEP, kryejnë sot ndalimin e funksionimit të pajisjeve të përdorura nga subjekti _____, sipas inventarit të mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Numri serial i pajisjes

Shënime të tjera:

GRUPI I INSPEKTIMIT

PËR SUBJEKTIN E INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. _____ prot.,

Tiranë më _____._____._____

VENDIM

Nr. _____, Datë _____._____._____

**PËR BLOKIMIN, INVENTARIZIMIN DHE SEKUESTRIMIN E PAJISJEVE TË
PËRDORURA NGA SUBJEKTI _____**

**GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE, PA AUTORIZIM/LICENCË TË AKEP**

Bazuar në Urdhrin nr. _____, datë _____._____._____, të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike (AKEP), Grupi i Inspektimit,

1. _____
2. _____
3. _____

konstaton se:

Për sa më sipër, bazuar në nenin 182 të ligjit nr 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. _____, datë _____._____.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP, Grupi i Inspektimit,

VENDOSI:

1. Bllokimin, inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të subjektit _____ gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komunikimeve elektronike pa autorizim të AKEP.
2. Kundër këtij vendimi, subjekti mund të ushtrojë ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit subjektit të inspektimit.

3. Pas kalimit të afatit të ankimit dhe në rast se pas shqyrtimit të fazave të ankimit, vendimi i inspektimit për bllokimin dhe sequestrimin e pajisjeve, vlerësohet si i ligjshëm, këto pajisje konfiskohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GRUPI I INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. ____ prot.,

Tiranë më ____ . ____ . ____

VENDIM

NR. ____ , DATË ____ . ____ . ____

**PËR NDALIMIN E FUNKSIONIMIT TË PAJISJEVE, TË PËRDORURA NGA
SUBJEKTI _____**

GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Bazuar në Urdhrin nr. ____ , datë ____ . ____ . ____ , të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike (AKEP), Grupi i Inspektimit,

1. _____
2. _____
3. _____

dhe në vijim të proces verbalit nr. ____ , datë ____ . ____ . ____ , sipas të cilit rezulton se:

Për sa më sipër, bazuar në nenin 182 të ligjit nr 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. ____ , date ____ . ____ . ____ të Këshillit Drejtues të AKEP, Grupi i Inspektimit

VENDOSI:

1. Ndalimin e funksionimit të pajisjeve të përdorura nga subjekti i inspektimit _____ , gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komunikimeve elektronike në kundërshtim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kundër këtij vendimi, subjekti mund të ushtrojë ankim në Këshillin Drejtues brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit subjektit të inspektimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GRUPI I INSPEKTIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Nr. ____ prot.,

Tiranë më ____ . ____ . ____

VENDIM

NR. ____ , DATË ____ . ____ . ____

PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV TË SUBJEKTIT

Bazuar në Urdhrin nr. ____ , datë ____ . ____ . ____ , të Kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike (AKEP), Grupi i Inspektimit, si më poshtë

1. _____
2. _____
3. _____

dhe në vijim të procesverbalit/eve nr. ____ , datë ____ . ____ . ____ , sipas të cilëve ka rezultuar se:

Për sa më sipër, bazuar në nenin 184 dhe 185 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me vendimin nr. ____ , datë ____ . ____ . 2026 të Këshillit Drejtues të AKEP, Grupi i Inspektimit, konstaton se shkeljet e subjektit _____ , klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe për këtë arsye:

VENDOSI:

1. Dënimin administrativ:
 - a. _____ ;
2. Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-
-
3. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, subjekti mund të ushtrojë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të tij, në Këshillin Drejtues të AKEP.
 4. Gjopa është titull ekzekutiv dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit. Në rast se gjopa e vendosur paguhet nga subjekti i sanksionuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit të AKEP, masa e gjobës ulet automatikisht me 15% të shumës së vendosur.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. *Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:*

GRUPI I INSPEKTIMIT

Formati i Kartës së Inspektorit të AKEP:

(Pjesa para)

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE KARTË INSPEKTORI	
Fotografi e inspektorit	
Emri:	
Mbiemri:	
Pozicioni:	
Data e lëshimit: xx/xx/20xx	

(Pjesa prapa)


<i>Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë AKEP.</i> Kodi i Kartës _____ www.akep.al info@akep.al

Formati i Vulës së AKEP për bllokimin e pajisjeve.

